

**ASSIST SHPK**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

---

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 18

**ASSIST sh.p.k***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	2,441,239	1,367,033
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	9,060,410	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	33,170,204	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	34,133,998	24,600
Inventari	8	500,000	-
Shpenzime të shtyra	9	127,421,741	-
<b>Total Aktive Afatshkurtra</b>		<b>206,727,592</b>	<b>1,391,633</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	10	38,697,157	-
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>38,697,157</b>	<b>-</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>245,424,749</b>	<b>1,391,633</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregëtare	11	15,484,629	88,400
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	12	503,367	-
Detyrime tatimore	13	2,129,391	12,460
Të tjera detyrime	14	4,614,118	62,246
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>22,731,505</b>	<b>163,106</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	15	220,424,900	1,373
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>220,424,900</b>	<b>1,373</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>243,156,405</b>	<b>164,479</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nënshkruar	16	1,400,000	1,400,000
Humbje të mbartura		(172,846)	-
Fitimi i ushtrimit		1,041,190	(172,846)
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>2,268,344</b>	<b>1,227,154</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>245,424,749</b>	<b>1,391,633</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**ASSIST sh.p.k***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	42,326,969	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	(280,167)	(30,965)
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>(26,244,226)</b>	<b>(81,870)</b>
1)Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(22,133,309)	-
2)Të tjera shpenzime	20	(4,110,917)	(81,870)
<b>Shpenzime të personelit</b>	21	<b>(15,791,968)</b>	<b>(60,018)</b>
1)Paga dhe shpërblime		(13,599,104)	(51,429)
2)Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(2,192,864)	(8,589)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(1,625,875)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	22	(107)	-
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare</b>	23	<b>2,984,744</b>	<b>7.00</b>
1)Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(558,844)	-
2)Shpenzime të tjera financiare		3,543,588	7.00
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>1,369,370</b>	<b>(172,846)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	24	<b>(328,180)</b>	<b>-</b>
1)Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(328,180)	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>1,041,190</b>	<b>(172,846)</b>
<b>Totali i te ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,041,190</b>	<b>(172,846)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**ASSIST sh.p.k***(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015</b>				
Fitimi / Humbja e vitit			(172,846)	(172,846)
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	1,400,000			1,400,000
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,400,000</b>	<b>-</b>	<b>(172,846)</b>	<b>1,227,154</b>
Fitimi / Humbja e vitit			1,041,190	1,041,190
Lëvizjet përmes kapitalit		(172,846)	172,846	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,400,000</b>	<b>(172,846)</b>	<b>1,041,190</b>	<b>2,268,344</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori Franco Fradiani shpk dhe janë firmosur si më poshtë:

  
Franco Fradiani  
Administrator



  
Mazars shpk  
Hartuesi i Pasqyrave Financiare

**M AZARS**  
Rr. Emin Duraku, Pall. "Bijakët"  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone : +355 42 27 80 15  
www.mazars.al | info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	1,041,190	(172,846)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(2,873,910)	30,958
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	298,180	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,625,875	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(76,340,012)	(24,600)
Rënie/(rritje) në inventarë	(500,000)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	17,778,970	118,737
Rritje/(rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(127,421,741)	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	4,491,249	44,369
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(181,900,199)</b>	<b>(3,382)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(40,323,032)	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(40,323,032)</b>	<b>-</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	1,400,000
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara	223,967,115	1,373
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>223,967,115</b>	<b>1,401,373</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>1,743,884</b>	<b>1,397,991</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,367,033	-
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(669,678)	(30,958)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 2,441,239</b>	<b>1,367,033</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

“Assist shpk” është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të rregjistrimeve më datë 17 Nëntor 2015 me NIPT L52317008R.  
Selia e shoqërisë është: Rruga “Emin Duraku”, Pall “Binjaket”, Nr.5, Tirane, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë është 1,400,000 lekë.

Administratori i shoqërisë është z.Franco Fradiani.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqëria e huaj “Assist s.p.a” e cila zotëron 100% të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është studimi, konsulenca, projektimi, realizimi dhe shërbimet e manaxhimit të kompanive, për ndërmarrjet dhe entet drejtuese për të mbështetur shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve të vetë klientëve.

Më 31 dhjetor 2016 shoqëria kishte 84 punonjës, (2015: 1 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2016</b>	<b>2015</b>
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79
GBP/LEK	157.56	186.59



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

**3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015:15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### **3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	2,441,239	1,367,033
	<u>2,441,239</u>	<u>1,367,033</u>

**5. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë për fatura të pa aprovuara	9,060,410	-
	<u>9,060,410</u>	<u>-</u>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të Arkëtueshme tregtare nga Assist SPA	33,170,204	-
	<u>33,170,204</u>	<u>-</u>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
TVSH	34,129,423	14,600
Tatim Fitimi	-	10,000
Detyrime doganore	4,575	-
	<u>34,133,998</u>	<u>24,600</u>

**8. Inventari**

Inventari i shoqërise për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Inventar i imet	500,000	-
	<u>500,000</u>	<u>-</u>

## 9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si me poshte për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	121,920,565	-
Parapagime Matrix Konstruksion	5,501,176	-
	<u>127,421,741</u>	<u>-</u>

## 10. Aktive Afatgjata Materiale

<i>Kosto</i>	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	-	-	-	-
Shtesa	25,289,048	14,624,904	409,080	40,323,032
Pakësime				-
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>25,289,048</b>	<b>14,624,904</b>	<b>409,080</b>	<b>40,323,032</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>				
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2015</b>	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	1,091,328	514,093	20,454	1,625,875
Pakësime				-
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>1,091,328</b>	<b>514,093</b>	<b>20,454</b>	<b>1,625,875</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>				
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2015</b>	-	-	-	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>24,197,720</b>	<b>14,110,811</b>	<b>388,626</b>	<b>38,697,157</b>

## 11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë vendas	6,822,325	88,400
Furnitorë vendas te huaj	8,596,323	-
Furnitorë vendas për fatura të pambërritura	65,981	-
	<u>15,484,629</u>	<u>88,400</u>

**12. Llogari te pagueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>December 31, 2016</u>	<u>December 31, 2015</u>
Te pagueshme Tregetare Assist S.p.a.	503,367	-
	<u>503,367</u>	<u>-</u>

**13. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,422,814	11,160
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	391,904	1,300
Tatimi Fitimi	288,180	-
Tatimi në Burim	26,493	-
	<u>2,129,391</u>	<u>12,460</u>

**14. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Pagat e punonjësve	4,535,618	44,369
Mazars shpk	78,500	13,590
Taksa Bashkie	-	4,287
	<u>4,614,118</u>	<u>62,246</u>

**15. Llogari të pagueshme afatgjata nga palët e lidhura**

Llogaritë e pagueshme afatgjata nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Finacim Assist S.p.a.	220,424,900	
	<u>220,424,900</u>	

**16. Kapitali aksionar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 1400,000 Leke i ndarë në 1 kuote, i zotëruar 100% nga shoqëria italiane "Assist spa".

**17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shërbim Call Center	33,266,559	-
Shërbim Call Center te pa aprovuara	9,060,410	-
	<u><b>42,326,969</b></u>	<u><b>-</b></u>

**18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(1,207,233)	(30,965)
Fitim nga këmbimet valutore	927,066	-
	<u><b>(280,167)</b></u>	<u><b>(30,965)</b></u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	42,326,969
<b>Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH</b>	<u><b>42,326,969</b></u>
Shërbime	42,326,969
<b>Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP</b>	<u><b>42,326,969</b></u>
Fitim nga këmbimet valutore	4,470,653
<b>Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit</b>	<u><u><b>46,797,622</b></u></u>

**19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Qera Zyra	14,469,846	-
Shërbim Konsulte rekrutim Stafi	3,429,694	-
Shpenzime përshtatje ambjenteve	1,949,892	-
Pajisje ndihmëse	987,237	-
Energji Elektrike	867,640	-
Shpenzime telekomunikacioni	413,000	-
Shpenzime trainimi për sigurinë në punë	16,000	-
	<u><b>22,133,309</b></u>	<u><b>-</b></u>



**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**20. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Konsulenc ekonomike	1,049,356	-
Konsulencë për studim tregu	632,638	-
Qera Hapësire publicitare	588,125	-
Të tjera	544,369	-
Shpenzime bankare	379,765	3,783
Konsulencë juridike	277,130	73,800
Shpenzime postare the telefonie	186,497	-
Prime Sigurimi	129,107	-
Shpenzime pritje	103,970	-
Kancelari	101,077	-
Taksa vendore	67,000	4,287
Qera Pajisje	41,400	-
License Microsoft Office 365	10,483	-
	<b>4,110,917</b>	<b>81,870</b>

**21. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Shpenzime për paga	13,599,104	51,429
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	2,192,864	8,589
	<b>15,791,968</b>	<b>60,018</b>

**22. Shpenzime te tjera**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>	<b>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</b>
Gjoba dhe penalitete	107	-
	<b>107</b>	<b>-</b>

**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**23. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për interesa	558,844	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	(3,543,588)	(7)
	<u>(2,984,744)</u>	<u>(7)</u>

**24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
<b><i>Fitimi para tatimit</i></b>	<b>1,369,370</b>	<b>(172,846)</b>
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	991,340	-
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	107	-
Shpenzime interesash të panjohura	519,357	
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	471,876	
<b><i>Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)</i></b>	<b>2,360,710</b>	<b>(172,846)</b>
Humbje fiskale e mbartur	(172,846)	-
<b><i>Tatim fitimi @15%</i></b>	<b>250,276</b>	<b>-</b>
	<u><b>1,041,190</b></u>	<u><b>(172,846)</b></u>

**25. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
<b>Bilanci kontabël</b>		
Të pagueshme ndaj Assist spa	220,928,267	1,373
	<u>220,928,267</u>	<u>1,373</u>
Të arkëtueshme nga Assist spa	33,170,204	
	<u>33,170,204</u>	<u>-</u>

**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

Transaksionete me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>		
Blerje nga palët e lidhura:		
Assist spa	558,800	-
	<u>558,800</u>	<u>-</u>
Shitje për palët e lidhura:		
Assist spa	33,266,559	-
	<u>33,266,559</u>	<u>-</u>

**24. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2016 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**26. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.